



MARSHIMI ONE BILLION RISING (NJË MILIARDË NË KËMBË)

14 shkurt 2015, ora 14, Sheshi Skënderbeu, Prishtinë

Të shtunën, me 14 shkurt 2015, organizohet fushata One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë), në më shumë se 190 vende të botës, për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Sipas statistikave, një në tri gra në planet, dhunohet apo përjeton dhunë në familje gjatë jetës së saj, që do të thotë një miliard gra.

Në shkurt të vitit 2013, një miliard gra dhe burra në gjithë botën, dolën në rrugë dhe përmes vallëzimit protesuan për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave përmes fushatës One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë). Edhe Kosova iu bashkangjiti kësaj fushate që nga fillimi.

Këtë vit, në kuadër të fushatës, do të organizohet një marshim me muzikë përmes daulleve, defave dhe darabukave për t'i thënë mjaft dhunës. Marshimi fillon në ora 14:00, para Teatrit Kombëtar drejt Sheshit Zahir Pajaziti.

Kjo fushatë në Kosovë organizohet nga një koalicion organizatash (Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Artpolis, Alter Habitus, Qendra dhe Programi për Studime Gjinore), ndërsa përkrahët nga UNFPA.